



Ku ndodhen të rinjtë sot?

RAPORT MONITORIMI

Gusht-Tetor 2022

QENDRESA QYTETARE



NED NATIONAL ENDOWMENT FOR DEMOCRACY
SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al



AUTOR
RENIS META

Tabela e Përmbajtjes

- Të rinjtë e papunësuar dhe as të përfshirë në forma të tjera trajnimi apo edukimi
- Emigrimi i të rinjve dhe humbja e kapitalit njerëzor të Shqipërisë
- Garancia Rinore Evropiane, një mekanizëm për të mbështetur të rinjtë që nuk janë në punësim, arsim apo aftësim (APAA)
- Në cilën fazë të procesit të implementimit të Garancisë Rinore ndodhet Shqipëria?
- Konkluzione
- Rekomandime
- Referenca

Të rinjtë e papunësuar dhe as të përfshirë në forma të tjera trajnimi apo edukimi

Papunësia e të rinjve mbetet një problem strukturor në Shqipëri dhe popullsia e re ka qenë një nga më të prekurat pasi shkalla e papunësisë për të rinjtë u rrit në 37.7% në 2021, që rezulton me 5.4 pikë përqindje më shumë se në qershor 2020 (Banka Botërore, 2021).¹ Riintegrimi i të rinjve në tregun e punës është duke ecur me ritme të ngadalta, pasi të dhënat tregojnë se nivelet e pjesëmarrjes së tyre kanë qenë të njëjta për dy tremujorë radhazi në vitin 2021 dhe përqindja nuk ka lëvizur ndjeshëm që nga viti 2020, kur pandemia e COVID-19 ishte në kulmin e saj.

Sipas publikimit të fundit të INSTAT, Tregu i Punës (2021)², shkalla e papunësisë për të rinjtë e moshës 15-24 vjeç është 27,1 %. Në raport me vitin paraardhës, shkalla e papunësisë së të rinjve ka pësuar një rritje prej 0,6 pikë përqindje (fq.17).

Shqetësues mbetet numri i lartë i të rinjve jo të punësuar dhe as të përfshirë në forma të tjera trajnimi apo edukimi, apo që nuk ndjekin shkollën. Në vitin 2021, të rinjtë e grupmoshës 15-29 vjeç, të cilët nuk ishin të punësuar, nuk ndiqnin shkollën apo ndonjë formim profesional, përbënin 26,1 % të të rinjve gjithsej.

Sipas INSTAT (2021) në këtë grup, 37,3 % e të rinjve janë të papunë dhe pjesa tjetër janë jashtë tregut të punës për arsye se janë të dekurajuar (15,4 %), duke përmbushur detyra dhe përgjegjësi familjare (17,5 %), ose (29,8 %) për arsye të tjera (fq.21).

Të rinjtë përballen me një tranzicion të vështirë kur hyjnë për herë të parë në tregun e punës, duke vënë në pikëpyetje cilësinë dhe vlefshmërinë e sistemit arsimor dhe përputhshmërinë me tregun e punës në Shqipëri. Në raportin e Komisionit Evropian, evidentohet

¹ World Bank (2021), As Economy Rebounds, Albania Has Opportunity to Build a More Sustainable Growth Model.

² INSTAT. (2022). Tregu i punës

shqetësimi që një përqindje shumë e lartë e të rinjve shqiptarë që nuk janë në punësim, arsim ose trajnim, ka arritur në 27.9% për ata të moshës 15-29 vjeç, dyfishi i mesatares së BE-27 prej 13.7% (të dhënat e vitit 2020 nga KE). Incidenca është më e lartë në mesin e të diplomuarve të mesëm të lartë (31.1%), të ndjekur nga të diplomuarit e lartë (27.5%), krahasuar me ata me më së shumti arsim fillor (24.9%). Po ashtu, prej kohësh evidentohen problematikat në cilësinë e arsimit dhe mos përputhshmërinë me tregun e punës (European Commission, 2022, fq.34).³

Referuar INSTAT (2021) gjatë vitit 2021, 30,7 % e popullsisë që i përket grupmoshës 15-64 vjeç që është ekonomikisht jo-aktive dhe pjesë e popullsisë jashtë forcave të punës është e dominuar nga nxënësit/studentët (33,3 %) (fq.21).⁴

Emigrimi i të rinjve dhe humbja e kapitalit njerëzor të Shqipërisë

Problemet kronike nga të cilat vuan tregu i punës dhe niveli i ulët i pagave në Shqipëri ndikojnë në numrin e ulët të të rinjve të angazhuar në tregun e punës, në trajnime apo kurse profesionale, si dhe krijojnë stimuj për emigrimin nga Shqipëria.

Shkalla mesatare e papunësisë në Shqipëri është më shumë se dyfishi i mesatares së OECD-së. Për shembull, pagat minimale në Gjermani dhe Francë janë më tepër se dy herë më të larta se në Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi dhe Serbi, dhe pothuajse katër herë më të larta se në Shqipëri (OECD, 2022, f.58).⁵ ***Për më tepër, punësimi informal mbetet një fenomen shqetësues që prek të rinjtë shqiptar (15-24 vjeç) me një***

³ European Commission. (2022). 2022 Economic Reform Programmes of Albania, Montenegro, North Macedonia, Serbia, Turkey, Bosnia and Herzegovina and Kosovo*. The Commission's Overview & Country Assessments. INSTITUTIONAL PAPER 180.

⁴ INSTAT. (2022). Tregu i punës.

⁵ OECD. (2022). LABOUR MIGRATION IN THE WESTERN BALKANS: MAPPING PATTERNS, ADDRESSING CHALLENGES AND REAPING BENEFITS.

në çdo dy të rinj që janë në punësim informal, veçanërisht ata të rinj me nivel të ulët arsimor (European Commission, 2022, fq.40).⁶

Në terma afatgjatë, emigrimi i vazhdueshëm i fuqisë punëtore të kualifikuar dhe të rinjve po zvogëlon kapitalin njerëzor të Shqipërisë (veçanërisht me ikjen e trurit). Largimi i profesionistëve dhe numri i ulët i individëve të kualifikuar është shqetësues, pasi kjo shtresë e popullsisë është e nevojshme për të mbështetur dhe shtyrë përpara produktivitetin ekonomik, inovacionin dhe konkurrencën ekonomike në vend.

Studimet kanë treguar se emigracioni shkakton mungesë të theksuar të fuqisë punëtore, si dhe shkakton mospërputhje të aftësive dhe kërkesës midis punëtorëve dhe bizneseve (Banka Botërore, 2018).⁷ Shqipëria do të duhet të trajtojë shkallën e saj të lartë të emigrimit (më e larta në vendet e OECD-së dhe nga të gjitha gjashtë ekonomitë e Ballkanit Perëndimor me 1 milion shqiptarë që jetojnë jashtë) dhe rrjedhjen e vazhdueshme të kapitalit njerëzor, veçanërisht në mesin e popullsisë së re (OECD, 2022).⁸

Shqipëria vazhdon të renditet ulët në **Indeksin e Konkurrueshmërisë së OECD-së për vitin 2021**, si dhe nën mesataren e Ballkanit Perëndimor (WB6) për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin. Sipas Komisionit Evropian (2022) kërkimi shkencor është ende i nënfinancuar sistematikisht nga burimet publike. Po ashtu, shpenzimet publike për kërkime kanë qenë të pamjaftueshme për të forcuar lidhjen midis biznesit dhe arsimit. Në të njëjtën kohë, investimi i Shqipërisë në arsimin terciar po humbet efektivitetin e tij për shkak të ikjes së vazhdueshme të trurit të të diplomuarve (fq.36).⁹

⁶ European Commission. (2022). 2022 Economic Reform Programmes of Albania, Montenegro, North Macedonia, Serbia, Turkey, Bosnia and Herzegovina and Kosovo*. The Commission's Overview & Country Assessments. INSTITUTIONAL PAPER 180.

⁷ World Bank. (2018). Western Balkans: Labor Market Trends 2018. World Bank Group.

⁸ OECD (2022), Labour Migration in the Western Balkans: Mapping Patterns, Addressing Challenges and Reaping Benefits.

⁹ European Commission. (2022). 2022 Economic Reform Programmes of Albania, Montenegro, North Macedonia, Serbia, Turkey, Bosnia and Herzegovina and Kosovo*. The Commission's Overview & Country Assessments. INSTITUTIONAL PAPER 180.

Aftësimi profesional dhe edukimi në Shqipëri vazhdojnë të mbeten të papërditësuar me kohën dhe me kërkesat e tregut të punës. Po ashtu, bashkëpunimi me sektorin privat është i pamjaftueshëm, bashkëpunim që do të ishte vendimtar për përmbushjen dhe përditësimin e aftësive të nevojshme që kërkon sektori privat (OECD, 2016).¹⁰

Në vlerësimin e Komisionit Evropian (2022), financimi dhe mbulimi që kanë politikat aktive të tregut të punës janë të pamjaftueshme dhe të nënfinacuara për të pasur një ndryshim thelbësor në uljen e numrit të punëkërkuarve të regjistruar. Për më tepër, arsimi dhe trajnimit profesional ende i mungon përfshirja më e madhe e bizneseve, si dhe mësuesit në arsimin parauniversitar janë ende të pakualifikuar mjaftueshëm për tu përshtatur me ndryshimet dhe kohën. Arsimi universitar vijon të mbetet i shkëputur nga tregu i punës dhe marrëdhënia midis bizneseve inovative dhe akademisë është e dobët, me financim të pamjaftueshëm për shkencën dhe kërkimin shkencor dhe kushte të pafavorshme për zhvillimin e start up-eve (European Commission, 2022, fq.21).¹¹

Garancia Rinore Evropiane, një mekanizëm për të mbështetur të rinjtë që nuk janë në punësim, arsim apo aftësim (APAA)

Garancia Rinore është një shtyllë e rëndësishme e Planit Ekonomik dhe Investimeve 2021-2027, e nisur nga Komisioni Evropian, Organizata Ndërkombëtare e Punës dhe European Training Foundation (ETF), për mbështetjen e Ballkanit Perëndimor dhe institucioneve përgjegjëse në rajon për të shtyrë përpara politikat e punësimit dhe angazhimit të të rinjve (ETF, 2021, f.4).¹² Garancia Rinore është një skemë e krijuar për të

¹⁰ OECD. (2016). Bridging Skills Gap in South East Europe: The Case of the Food and Beverage Processing Sector. Paris: OECD Publishing.

¹¹ European Commission. (2022). 2022 Economic Reform Programmes of Albania, Montenegro, North Macedonia, Serbia, Turkey, Bosnia and Herzegovina and Kosovo*. The Commission's Overview & Country Assessments. INSTITUTIONAL PAPER 180.

¹² European Training Foundation. (2021). Youth Disengagement and Skills Mismatch in the Western Balkans.

mbështetur dhe siguruar që të gjithë të rinjtë e moshës 15 deri në 29 vjeç të marrin një ofertë cilësore të punësimit, arsimit të vazhdueshëm, praktikës ose trajnimit profesional brenda një periudhe katërmujore pasi mbeten të papunë ose kanë lënë arsimin formal apo nuk janë të angazhuar në praktikë/trajnim.

Komisioni Evropian (KE), ka propozuar zbatimin e skemave të Garancisë Rinore në Ballkanin Perëndimor në katër faza të zbatimit, me një fazë zero të rritjes së ndërgjegjësimit si dhe katër fazat e zbatimit që pasojnë, si më poshtë:

- **Faza 0:** Rritja e ndërgjegjësimit, angazhimi politik dhe krijimi i një Task Force;
- **Faza 1:** Planet e Zbatimit të Garancisë Rinore;
- **Faza 2:** Puna përgatitore - ndërtimi i kapaciteteve të palëve të interesuara dhe autoriteteve;
- **Faza 3:** Faza pilot - për të testuar masat e planifikuara;
- **Faza 4:** Faza e zbatimit të plotë - bazuar në vlerësimin e fazës pilot identifikohen përmirësimet që duhen bërë në planin e Garancisë Rinore dhe fillimi i zbatimit të plotë.

Tranzicioni i të rinjve nga arsimit në tregun e punës në vitet e fundit është kthyer në një problem serioz, ndaj Garancia Rinore mund të bëjë ndryshimin, duke siguruar një ofertë të mirë cilësore punësimi, trajnimit/praktike ose edukimi për të gjithë të rinjtë.

Vendet e rajonit duke përfshirë Shqipërinë janë zotuar të hartojnë dhe miratojnë planet e zbatimit të Garancisë Rinore deri në mesin e vitit 2022 (ETF, 2021, f.4).¹³ Por në cilën fazë të procesit të implementimit të Garancisë Rinore ndodhet Shqipëria dhe si ka ecur procesi?

¹³ European Training Foundation. (2021). Youth Disengagement and Skills Mismatch in the Western Balkans.

Në cilën fazë të procesit të implementimit të Garancisë Rinore ndodhet Shqipëria?

Ndër deklaratat e para zyrtare të Ministrisë përgjegjëse për mbarëvajtjen e procesit të implemetimit të Garancisë Rinore kanë ardhur në Takimin e Dytë Ministror të Bashkimit Evropian dhe Ballkanit Perëndimor për Punësimin dhe Çështjet Sociale nga ish-Ministrja e Financave dhe Ekonomisë, Anila Denaj. Në këtë takim përfaqësuesit e Ballkanit Perëndimor u angazhuan për të krijuar, zbatuar dhe përmirësuar gradualisht skemat e Garancisë Rinore nëpërmjet mbështetjes së Bashkimit Evropian. Gjatë kësaj periudhe u pohua nga ministria e linjës se Shqipëria ishte në fazën e parë të procesit “Fazën 1 – Planet e Zbatimit”.¹⁴

Në Prill të vitit 2022 është organizuar mbledhja e grupit ndërinstytucional të punës që do të hartojë Skemën e Garancisë Rinore me udhëheqjen e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, së bashku me Ministrinë e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, dhe Ministrinë e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët. Pas mbledhjes u pohua nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë se pilotimi i skemës do të fillonte në gjysmën e dytë të vitit 2022 në disa zona dhe në vitin 2023 do të zgjeroheshin zonat e pilotimit.¹⁵ *Përtej deklaratave të ardhura në kuadër të mbledhjeve ndërinstytucionale, ende nuk ka informacion dhe rezultate konkrete për publikun mbi procesin e pilotimit të skemës dhe vlerësimin e implemtimit në kuadër të fazës pilot. Po ashtu, mungon feedback-u për rezultatet e marra nga fazat e para të procesit.*

Në Draft-Strategjinë Kombëtare e Rinisë 2022-2029, përmendet se Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me Ministrinë e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët është në procesin e hartimit të një skeme për Garancinë Rinore në Shqipëri. Garancia Rinore në Shqipëri do të

¹⁴ Faqja zyrtare online e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Aksuar për herë të fundit në 7/12/2022.

¹⁵ Faqja Online e Agjensisë Telegrafike Shqiptare. Aksesuar për herë të fundit në: 7/12/2022

bazohet në një grup pune ndërinstitucional dhe në një grup teknik për hartimin e planit kombëtar të garancisë rinore, si dhe mbetet të përcaktohet ende koordinatori kombëtar.¹⁶

Vlen të evidentohet se ende nuk janë marrë hapa thelbësorë e konkret për të shtyrë përpara procesin në implementimin e Garancisë nga ana e institucioneve, si dhe ende nuk kemi një pozicion të qartë se ku ndodhet procesi.

Duhet të mbahet në konsideratë përfshirja dhe pjesëmarrja aktive e të rinjve si në hartimin ashtu edhe në implementimin e skemës si një nga 'përbërësit' kyç për të pasur rezultate nga implementimi i skemës "Garancia Rinore". Andaj, është thelbësore që institucionet përkatëse të sigurohen që të rinjtë dhe organizatat rinore të angazhuar në punën me të rinjtë dhe në shoqërinë civile të kenë një vend në tryezë për të shtyrë përpara implementimin e kësaj skeme të rëndësishme për trajtimin e papunësisë së të rinjve në Shqipëri.

Shqipëria duhet të ndjekë shembullin pozitiv të Maqedonisë së Veriut, pionere e Garancisë Rinore në rajon. Maqedonia e Veriut prej implementimit për herë të parë të Garancisë Rinore në vitin 2018 ka pasur një ulje prej gati 8.9% të përqindjes së papunësisë afatgjatë të të rinjve midis 2017 dhe 2019. (RCC, 2021).¹⁷ Bazuar në suksesin e fazës pilot Ministria e Punës dhe Politikave Sociale në Maqedoninë e Veriut aktualisht është duke nisur procesin e planifikimit të Garancisë Rinore për periudhën 2023-2025.¹⁸

¹⁶ Draft-Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029.

¹⁷ Regional Cooperation Council (RCC). (2021). Youth Guarantee in Western Balkans.

¹⁸ Connecting Youth. (2022). Youth Guarantee Deployment in the WB6. Institutional set-up and a perspective from youth organizations.

Konkluzione

Papunësia e të rinjve e kombinuar me aksesin e kufizuar në arsim dhe trajnim mund të ketë një efekt të rëndë në terma afatgjatë, duke rritur rrezikun e papunësisë në të ardhmen, dhe duke shtyrë drejt varfërisë të rinjtë (APAA). Të rinjtë as në punësim, as në arsim apo trajnim rrezikojnë të humbin plotësisht lidhjen me tregun e punës, duke kufizuar mundësitë e tyre për të dalë nga varfëria dhe për të kontribuar efektivisht në zhvillimin ekonomik të vendit.

Nga pikëpamja demografike dhe ekonomike, emigrimi, papunësia e të rinjve dhe mos angazhimi i tyre në edukim apo trajnim profesional do të vështirësoj situatën ku gjenden të rinjtë, si dhe do të përkeqësojë mungesën e fuqisë punëtore të kualifikuar, veçanërisht në sektorë kyç të ekonomisë. Një politikë gjithëpërfshirëse, e ndërlidhur me politikat demografike, migracionin dhe integrimin e të rinjve në tregun e punës apo aftësimin e tyre profesional, ende mungon në vend.

Rrjedhja e trurit dhe papunësia kronike po redukton kapitalin njerëzor të Shqipërisë, jetik për rritjen ekonomike, ndërkohë që politikat dhe programet ekzistuese nuk po arrijnë të zhvillojnë kapitalin njerëzor të atyre që mbeten prapa. Nga ana tjetër, ky është një faktor që pengon konkurrencën ekonomike të Shqipërisë, aftësinë për të rritur produktivitetin e punës dhe kapacitetin për inovacion dhe përparim në fushën e teknologjisë, komponentë thelbësorë për rritjen e ekonomië së vendit.

Rekomandime

- Përqindja e lartë e të rinjve të cilët nuk janë në punësim, as në shkollim ose aftësim profesional, imponon nevojën e investimeve në politikat aktive të tregut të punës me qëllim për të mbështetur punësimin dhe vetëpunësimin e të rinjve dhe për të intensifikuar programet për trajnimin profesional të tyre.
- Insitucionet përgjegjëse duhet të identifikojnë dhe regjistrojnë numrin e plotë të të rinjve jo të punësuar dhe as të përfshirë në forma të tjera trajnimi apo edukimi, pasi një pjesë e madhe e tyre nuk figurojnë si pjesë e sistemit të punëkërkesve dhe kjo ndikon në neglizhimin e tyre dhe lënien jashtë vëmendjes së insitucioneve.
- Duhet ti kushtohet me tepër vëmendje politikave dhe investimeve në kuadër të përmirësimit të arsimit profesional ekzistues në vend për t'iu përgjigjur nevojave dhe aftësive që kërkon të tregu i punës. Rritja e investimeve për të përmirësuar cilësinë e sistemeve ekzistuese të arsimit profesional do të jetë kritike për ndërtimin e themeleve të aftësive të brezave të ardhshëm.
- Shqipëria ende nuk ka bërë hapa thelbësorë përpara për implementimin e Garancisë Rinore. Duke parë numrin e lartë të të rinjve të cilët janë të punësuar, nuk ndjekin shkollën apo forma të tjera trajnimi/formimi profesional, duhet të përshpejtohen dhe të ndërmerren hapa të rëndësishëm në trajtimin e këtij fenomeni. Insitucionet përgjegjëse për implementimin e skemës duhet të hedhin hapa konkret më tej për fillim e procesit dhe implementimin e Garancisë Rinore.
- Insitucionet që udhëheqin procesin e Garancisë Rinore duhet të garantojnë përfshirjen dhe pjesëmarrjen e të rinjve dhe organizatave rinore të angazhuar në punën me të rinjtë, si gjatë procesit të hartimit ashtu edhe në implementimin e skemës.

Referenca

World Bank (2021), As Economy Rebounds, Albania Has Opportunity to Build a More Sustainable Growth Model, Aksesuar në:

<https://www.worldbank.org/en/news/press-release/2021/10/21/aseconomy-rebounds-albania-has-opportunity-to-build-a-more-sustainable-growth-model>.

World Bank. (2018). Western Balkans: Labor Market Trends 2018. World Bank Group.

European Commission. (2022). 2022 Economic Reform Programmes of Albania, Montenegro, North Macedonia, Serbia, Turkey, Bosnia and Herzegovina and Kosovo*. The Commission's Overview & Country Assessments. INSTITUTIONAL PAPER 180.

Aksesuar në: https://ec.europa.eu/info/sites/default/files/economy-finance/ip180_en_0.pdf

INSTAT. (2022). Tregu i punës.

Aksesuar në: <http://www.instat.gov.al/al/publikime/librat/2022/tregu-i-pun%C3%ABs-2021/>

OECD. (2022). LABOUR MIGRATION IN THE WESTERN BALKANS: MAPPING PATTERNS, ADDRESSING CHALLENGES AND REAPING BENEFITS.

Aksesuar në: <https://www.oecd.org/south-east-europe/programme/Labour-Migration-report.pdf>

OECD. (2016). Bridging Skills Gap in South East Europe: The Case of the Food and Beverage Processing Sector. Paris: OECD Publishing.

European Training Foundation. (2021). Youth Disengagement and Skills Mismatch in the Western Balkans.

Aksesuar në:

https://www.etf.europa.eu/sites/default/files/2021-11/02_youth_western_balkans_final.pdf

Faqja Online e Agjensisë Telegrafike Shqiptare.

Aksesuar për herë të fundit në: 7/12/2022. <https://ata.gov.al/2022/11/01/ibrahimaj-skema-e-garancise-rinore-integrim-ne-tregun-e-punes/>

Faqja zyrtare online e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Aksesuar për herë të fundit në 7/12/2022, në: <https://financa.gov.al/denaj-netakimin-e-ministrave-te-ballkanit-te-krijojme-nje-treg-pune-te-qendrueshem-dhe-gjithperfishires/>

Connecting Youth. (2022). Youth Guarantee Deployment in the WB6. Institutional set-up and a perspective from youth organizations.

Aksesuar në: <https://www.vijecemladih.ba/wp-content/uploads/2022/06/Youth-Guarantee-Deployment-in-the-WB6.pdf>

Draft-Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029.

Aksesuar në:

https://konsultimipublik.gov.al/documents/RENJK_500_I.%20Strategjia%20Kombetar-e%20e%20Rinise%202022.pdf

Regional Cooperation Council (RCC). (2021). Youth Guarantee in Western Balkans.

Aksesuar në: <https://www.rcc.int/docs/575/leaflet-youth-guarantee-in-western-balkans>

#QËNDRESË / MIRËQEVERISJE

QENDRESA
QYTETARE



NED

NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al